

BILINGUALISM – CODE CHANGING AND INTERFERENCES AT ALBANIAN UNIVERSITY STUDENTS IN ITALY

Gjilda Alimhilli Prendushi

Albanian Language and Literature. University of Bari “Aldo Moro” Bari. Italy
E mail: gjilda.prendushi@uniba.it

Abstract

In this paper, we present some issues about the languages in contact within the Albanian language community in Italy. For this purpose, we have investigated linguistic and bilingual phenomena of Albanian students in Italian university environments and we have relied an analysis of some free conversations. The purpose of this paper is to describe not only the current state of the phenomenon, but also the particular type of entries in this lexicon, as well as the phonetic, semantic and grammatical changes in a general linguistic contact situation. The main emphasis will be on changing of the language in lexicon-semantic and grammatical-functional areas under the influence of sociolinguistic factors. So, we will try to demonstrate and support the hypothesis that bilingual speakers do not strictly separate the vocabulary and grammar of two or more languages. But they combine them with each other in the most economic way possible. Particular attention will be given to the issues as: where the language is more rapidly changing through the contact, what are the preferred paths in this process, and so on. Also, many other questions remain to be clarified in the future as: which areas resists more to the adaptation, and can they show signs of independent development differently from the language of contact, etc.

Keywords: *bilingualism, code, Albanian, Italian, linguistic interference.*

BILINGUIZMI – NDRYSHIMI I KODIT DHE INTERFERENCAT TEK STUDENTË UNIVERSITARE SHQIPTARË NË ITALI

1. Hyrje

Në këtë artikull kemi parashtruar disa çështje rreth gjuhëve në kontakt në bashkësinë shqipfolëse në Itali. Për këtë qëllim, kemi hetuar dukuri gjuhësore dhe të dygjuhësisë individuale në mjedise universitare italiane me studentë shqiptarë dhe jemi mbështetur mbi analizën e bisedave të lira.

Qëllimi i këtij punimi është që të përshkruajë jo vetëm gjendjen aktuale të këtij fenomeni, por edhe llojin e veçantë të hyrjeve në këtë leksik, si dhe ndryshimet fonetike, semantike dhe gramatikore në një situatë të kontaktit të përgjithshëm gjuhësor.

Theksi kryesor do të vihet në ndryshimin e gjuhës në fushat leksiko-semantike dhe gramatikore-funksionale nën ndikimin e faktorëve sociolinguistikë. Kështu, do të përpiqemi të tregojmë dhe të mbështesim hipotezën se, folësit dygjuhësh nuk e ndajnë në mënyrë strikte fjalorin dhe gramatikën e dy ose më shumë gjuhëve, por ata i kombinojnë në mënyrën më ekonomike të mundshme.

Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet çështjeve: ku më shumë dhe më shpejt ndryshon gjuha përmes kontaktit, ç'rrugë janë zgjedhur në këtë proces etj. Gjithashtu, mbeten edhe shumë pyetje të tjera për t'u sqaruar në të ardhmen si, cilat fusha i rezistojnë adaptimit, a mund të shfaqin shenja të zhvillimeve të pavarura të dallueshme nga gjuha e kontaktit etj.

2. Rreth dygjuhësisë në bashkësinë gjuhësore shqiptare

Për problematikën e kontakteve gjuhësore, interferimit nga njëra gjuhë në tjetrën, dygjuhësisë dhe dukurive të tjera edhe etnokulturore, që rrjedhin prej tyre, është shkruar mjaft. Me interes do të jetë edhe shqyrtimi e studimi sa më konkret i situatës dhe i shfaqjeve të dygjuhësisë së emigracioneve më të reja shqiptare, i cili përbën edhe objektin e këtij artikulli.

Koncepti i dygjuhësisë në vetvete është mjaft i ndërlikuar. Por studiues të ndryshëm kanë arritur pothuajse në të njëjtin përfundim: situatë e dygjuhësisë është atëherë kur njeriu shërbehet rrjedhshëm, sipas situatave të jetës së tij të përditshme, nga dy gjuhë për të komunikuar me të tjerët dhe kur këtë komunikim dygjuhësor e pranojnë si mjedisi ashtu edhe situata e përgjithshme sociolinguistike. E gjejmë me vend klasifikimin sipas gjuhëtarit Shkurtaj (2009: 284-294), i cili flet për këto lloje të dygjuhësisë: dygjuhësi familjare që rrjedh nga martesë të përziera dhe dygjuhësi të emigracionit.

Dygjuhësia e emigracionit ka prirje të zhvillohet e të përhapet shumë aktualisht. Të dhënat statistikore tregojnë se gjysma e popullsisë së botës është dygjuhëshe, që do të thotë se jeta e tyre e përditshme karakterizohet nga lëvizje të vazhdueshme në mes të dy ose më shumë gjuhëve. Ky fenomen është në rritje, dhe kjo vjen për shkak të emigracionit ndërkombëtar në masë, i cili solli një dukuri të re: ndërkëmbimin e kodeve të komunikimit gjuhësor dhe përgjithësisht të shkëmbimeve kulturore e shpirtërore midis grupeve ardhëse me ato vendase. Shpesh, komuniteti dygjuhësh përdor gjuhë të ndryshme në kontekste të ndryshme: një gjuhë në shtëpi, një tjetër në rrugë, në vendin e punës ose në studim apo edhe një gjuhë me anëtarët më të moshuar të familjes dhe një tjetër me më të rinjtë. Pra, kemi aftësinë e folësit për ta ndryshuar gjuhën në varësi të personit që flet, duke iu përgjigjur pyetjeve të J. Fishman-it: *Who speaks, what language, to whom and when.*

Për shqiptarët dygjuhësia tekniko-ekonomike po bëhet e zakonshme. Një e pesta e tyre si emigrantë tashmë jetojnë rregullisht me një gjuhë tjetër të dytë. Një pjesë tjetër dalin jashtë vendit dhe kthehen përsëri në atdhe në mënyrë të përsëritur. Brenda vendit jo vetëm nëpërmjet arsimit të rregullt, por edhe me shumë rrugë të tjera (e sidomos nëpërmjet televizionit për italishten) gjithashtu mjaft prej tyre kanë përvetësuar një gjuhë të dytë. Konstatimi i përgjithshëm është se tashmë 30 për qind e shqiptarëve të Shqipërisë është dygjuhëshe (Shih Lloshi, 2001: 50).

Studimi mbi dygjuhësinë mund të përfshijë probleme të veçanta (Baker, A., Hengeveld, K., 2012: 404-407). Njëri prej tyre i takon komunitetit gjuhësor, rreth të cilit mund të dalin një numër pyetjesh: Cila është pozita relative e gjuhëve të ndryshme në një shoqëri dygjuhëshe, dhe se si ajo po ndryshon? Një aspekt tjetër mund të lidhet me folësin vetë, i cili është dygjuhësh: Si ndikon dygjuhësia në përdoruesit e gjuhës, në veçanti, në mënyrën se si ata i përdorin gjuhët? Së fundi, gjuha vetë mund të bëhet objekt studimi: Çfarë ndodh me gjuhët që janë në kontakt, pra, të folura në të njëjtin komunitet? Si mund të ndikojnë tek njëra-tjetra? Pikërisht, çështja e fundit është objekti i kërkimit tonë: ndikimi i gjuhës italiane në një masë të komunitetit shqiptar, dhe gjuha e tyre, duke filluar rreth një çerek shekulli më parë (Sipas ALBITALIA-s, në vitin 2014 rezultojnë 490.483 banues shqiptarë në Itali). Për këtë qëllim, kemi vëzhguar dukuri gjuhësore dhe të dygjuhësisë individuale në mjedise universitare italiane me studentë shqiptarë (Sondazhet e AlmaLaurea-s informojnë se, në vitin 2014 në universitetet italiane ishin shkruar 7300 të huaj, ku mbi dy të tretat e të diplomuarve, duke zënë vendin e parë, janë të rinjtë shqiptarë) dhe jemi mbështetur mbi analizën e bisedave të

lira. Rezultatet e paraqitura nuk duhet të përgjithësohen, ata vetëm aspirojnë për të zgjeruar të kuptuarit tonë mbi këtë grup të veçantë, dhe mbi fenomenet gjuhësore dhe sociale të kontaktit mes dy gjuhëve, shqipes dhe italishtes.

3. Shqipja dhe gjuhët në kontakt

Siç është shprehur Weinreich (1964:71), rezultati i kontaktit gjuhësor është folësi dygjuhësh o shumëgjuhësh. Ata ndajnë vazhdimisht dy kodet e komunikimit në përdorimin e përditshëm. Në përgjithësi, dygjuhësit bëjnë një ndarje të qartë të funksioneve, duke përdorur që te dyja gjuhët në situata të ndryshme. Shumë faktorë në një bisedë, si argumenti, marrësi dhe vendndodhja, mund të ndikojnë në mënyrën e zgjedhjes dhe në përdorimin e gjuhës. A arrijnë ata gjithmonë të mbajnë dy gjuhët të ndara njerën nga tjetra? Për disa përgjigjja është po, për të tjerët jo (Më tej shih Filippi, R., Leech, R., Thomas, M. S., Green, D. W., & Dick, F., 2012: 858-872). Por është fakt që, gjuhët e kontaktit ndikojnë reciprokisht tek njera tjetra në mendjen e folësve dhe ndryshojnë si rezultat i ndërhyrjes së ndërsjelltë (Breu, 2003: 353). Emigracioni i madh i viteve të tranzicionit në Shqipëri, jeta e përbashkët me shoqëritë e tjera, nevoja e madhe për komunikim ka shtuar jo vetëm njohuritë për gjuhët e huaja, por edhe përdorimin e përditshëm të tyre në kontekstet e sipërpërmendura. Dygjuhësia tek ne është tipike sidomos tek moshat e reja. Bëhet fjalë sidomos për një pjesë të mirë të shoqërisë shqiptare që jeton, punon o studion jashtë vendit. Është, pikërisht, ky brez objekti i vëzhgimit tonë.

Së pari, shembujt e grumbulluar na çojnë në dy grupime:

- Në grupin e parë, vërejmë ndërfitje të thjeshta të shumta që gjenden në fjali me strukturë bazale të qartë në shqip. Ky tip kodit ndihmës, praktikohet nga studentët me njohuri të pakta minimale të italishtes dhe tregon një kohëzgjatje të shkurtër të qëndrimit në Itali.

Në disa prej këtyre rasteve, përfshihen fjalë-frazë, si *sicuramente* për *sigurisht*, *bene* për *mirë* etj apo edhe pasthirrat *bravo* për *të lumtë*, *grazie* për *faleminderit* etj. dhe mbi të gjitha përsëritjet, që në përgjithësi janë të lidhura me kontekstin italian në të cilën zhvillohet biseda. Kemi ndeshur shumë shpesh përdorimin *ciao* në vend të përsëritjeve *mirupafshim*, *mirëdita* apo *mirëmbërëma*. Kjo fjalë ka hyrë në përdorim në shumë raste edhe në Shqipëri, kryesisht në qytetet e mëdha, si një element i modernizimit apo thjesht për formën e saj të shkurtër, faktori shoqëror i quajtur ekonomia e gjuhës (Krahaso Vicentini 2003: 37-57, Words 3: The economy principle in language). Gjithashtu, të njëjtën gjë mund të themi edhe për *salve* në vend të *përsëritjeve*, ku e gjejmë të përdorur edhe në situata ku duhesh përdorur *mirëdita* apo *mirëmbërëma* etj.

- Nga ana tjetër kemi konstatuar grupin e dytë, i cili paraqitet më i zhvilluar dhe me kompleksitet gjuhësor më të lartë (Soh, K. C., 2012: 249-264).

Në këtë rast kemi të bëjmë me kodin tregues, grupo-identitar, është një vazhdim a zhvillim i mundshëm. Paraqitet më kompleks për arsye se, së pari, kompetenca dygjuhësore e folësve është më e lartë, dhe, së dyti, funksionaliteti i ndryshuar, duke qenë se në këtë variant, mënyra dygjuhësore e të folurit nuk shërben thjesht si mjet ndihmës për ta bërë më ekonomik komunikimin, por si mjet përmes të cilit folësi mund ta shprehë në mënyrë ekspresive identitetin dygjuhësor dhe dykulturore të tij. P.sh. *U dëgjova me profesororeshën di glottologia. Mbetem, që nesër, di incontrarci nell'aula 23 për U dëgjova me profesororeshën e glottologjisë. Mbetem, që nesër, të takohemi në aulën 23.*

3.1. Dukuritë e interferencës

Kontakti mes gjuhëve është baza e testimit të fenomeneve të ndryshme gjuhësore në një komunitet (Për receptorët gjuhësorë apo sistemet sociale-komunikuese shih, Jashar-Nasteva:

1998). Disa nga këto fenomene janë interferenca dhe koncepte të tjera sociolinguistike si: përzjerja dhe ndërrimi i kodit. Së pari, është e nevojshme që të sqarojmë fenomenin e interferencës që e ndeshim tek dygjuhësit. Ndërhyrja konsiston në transferimin e elementeve nga një gjuhë në një tjetër në nivele të ndryshme gjuhësore, është pikërisht kjo që çon në rritjen e incidencës së ndërrimit dhe të përzjerjes së kodit tek dygjuhësit. Kur ndryshimi e kodit, ndërrimi dhe përzjerja e tij, verifikohen për të kompensuar vështirësitë në gjuhë, në këtë rast, mund t'i shohim ata si interferencë, por jo kur përdoret si një mjet sociolinguistik. Shkurtimisht, përzjerja e kodit është përcaktuar si alternimi i dy ose më shumë gjuhëve brenda në një fjali. Procesi i përzjerjes së kodit kuptohet si futja e një kategorie leksikore të ndryshme, pa pasë lidhje me një strukturë të dhënë. P.sh. *E kam gati tesi-n*, ku emri *tesi* për *diplomë* lakohet sipas shqipes, apo *Mbrëmë e elaboro-va*, folja *elaborare* për *përpunoj* merr mbaresën e zgjedhimit foljor të gjuhës shqipe. Në këtë rast, folësit përdorin rregullat e gjuhës së parë (L1) në gjuhën e dytë (L2) dhe anasjelltas.

Ndërsa, ndërrimi i kodit përbën një proces normal të kalimit të të dy gjuhëve, brenda së njëjtës fjali ose të njëjtit fragment ligjërimit. Më konkretisht, ndërrimi i kodit mund të përkufizohet si alternanca ndërvendosëse e gjuhëve brenda një shprehjeje të vetme apo një bisede: *E ndoqa leksionin, era molto interessante për E ndoqa leksionin, ishte shumë interesant.*

Mënjanimi apo shmangia nga kodi shoqërohet, shpesh, me glosa shpjeguese, me fraza ose lokuzione të përdorura për të shpjeguar se një farë elementi është shkëputur nga një kod tjetër, si: *In bocca al lupo...si themi ne, paç fat!*

Ndodh që një mesazh i formuluar në një kod përsëritet në tjetrin. Në këto raste përsëritja shërben për të sqaruar një koncept: *Të mërkuren profesori ka takim, ricevimento.*

Duke qëndruar në këtë lëmë, vërejmë një tjetër shembull, ku del qartë ndërrimi i kodit: *Më dhanë 110 e lode.* Shprehja pasqyron sistemin e vlerësimit universitar italian. Ky ndryshim është i lidhur me territorin.

Në këto raste, vërejmë që fillimi i frazës është në shqip, kurse thelbi apo sqarimi është në gjuhën italiane.

Dallimi mes përzjerjes së kodit dhe ndërrimit të kodit mund të lidhet me formalitetin e situatës. Përzjerja e kodit ndodh në një rrethanë më pak formale, ndërsa ndërrimi i tij në të kundërtën.

Është e qartë se studentët, të marrë si referim, përdorin italishten si mjet komunikues në universitet, në administratë, në paraqitjet verbale dhe në situata të tjera formale, ndërsa shqipen në rrethin familjar dhe në mesin e të afërmeve si edhe në mjedise të ngjashme. Pra, zgjedhja e gjuhës përcaktohet nga faktorët rrethanorë, ashtu si me zgjedhjet stilistike që bëjnë njerëzit në një gjuhë të vetme.

Më e rëndësishmja është se, me zgjedhjen e gjuhës nga ana e tyre mund të lëvizë dhe të ndryshojë toni në një situatë, nga formale në të rastit. Në rrjedhën edhe të një bisede të vetme mund të vëzhgohet alternanca e gjuhëve dhe, këtu, do të kemi një ndryshim të kodit të komunikimit. Në këtë situatë jemi hasur kur flitet për grupe të përziera, studentë italianë dhe shqiptarë, por ndonjëherë edhe me vetëm studentë shqiptarë.

3.2. *Format e huazimit dhe përshtatja e strukturës*

Pas viteve '90 e deri sot, trysnia e gjuhëve të tjera për të futur fjalë në gjuhën shqipe është më e madhe, sesa forca e shqipes për t'u bërë qëndresë këtyre huazimeve. Në këtë fazë folësit e gjuhës, të përballur me realitete të papritura, që lëkundin *status quo*-në e tyre në kufijtë e mbijetesës, nuk mund të kenë vetëdije të qetë gjuhësore në mbrojtje të gjuhës amtare. Pragmatizmi për mbijetesë rrit nevojën për një komunikim global utilitar që shtrihet përtej caqeve të idiomës kombëtare (Rrokaj, 2014: 37).

Shenja më e dukshme e kontaktit të shqipes me gjuhët e huaja përkatëse të vendeve ku ndodhen shqiptarët në botë janë huazimet leksikore, po edhe morfosintaksore nga gjuhët e huaja (Huazimet nga italishtja janë më të shumtat në numër, por shqyrtimi i tyre nuk është objekti ynë. Me italianizmat është marrë në disa punime studiuesja Kristina Jorgaqi, shih më tej: 1998, 1997, 1992).

Tek studentët e marrë në vëzhgim hasim huazime, të cilat na paraqiten të dendura në përdorim. Në përgjithësi prirja ndaj mbartjes leksikore është në fakt, cilësi e folësve që kanë kompetencë kryesisht monolingvistike, ose që, sidoqoftë, kanë vështirësi ta ndryshojnë kodin. Këtu mund të bëjmë një dallim midis huazimeve të lira dhe huazimeve të përshtatura fonomorfologjikisht ndaj gjuhës zotëruese. Në bisedat ndërmjet studentëve të të dy grupeve (sipas ndarjes në fillim të këtij paragrafi), ndeshim me shumicë huazimeve të përshtatura.

Siç shkruan Breu (2003:361), adaptimet leksikore nuk zhvillohen vetëm me anë të ndryshimeve semantike, por edhe me huazimin e leksemeve të plota (në formë dhe përmbajtje). Këtu duhet të dallojmë zëvendësimin e leksemave ekzistuese dhe huamarrjes për të shprehur koncepte të reja.

Tek shembulli *Do ta jap lauren për Do ta jap diplomën* kemi ndryshime të kodit lidhur me karakteristikat e vendit ku banojnë dhe studiojnë studentët tanë. Përdorimi i termit *laurea* ka hyrë në gjuhën shqipe me një kuptim të ri (Shih mbi kuptimin e këtij termi (*Fjalori i gjuhës së sotme*, 1984:595). Ky është një rast i qartë i interferencës, ku emri *laure*-n vjen nga italishtja *la laurea* dhe është, në këtë rast, e plotësuar nga mbaresa e rasës kallëzore të gjinisë femërore, pra, është shqiptarizuar nga ana morfologjike. Termi është një huazim i nevojshëm dhe me prestigj dhe kjo është padyshim e lidhur me realitetin italian. Korrespondenti i tij në shqip është *diploma universitare*. Studentët në fjalë janë duke u diplomuar në Itali, kështu që është e natyrshme që të përdorin fjalën italiane dhe më pas ta mbartin në sistemin e gjuhës shqipe. Ky term përdoret në Shqipëri edhe nga ish-studentët e diplomuar në Itali, të cilët duke folur për titullin e tyre gjithnjë shprehen me termin *laurea*. Sigurisht të shprehurit me këtë term, siç e theksuam edhe më lart, lidhet edhe me prestigjin që ky sjell në vetvete.

Në rrethanat e sotme është e dukshme kufizueshmëria e hyrjes së leksikut të huaj në leksikonin e përgjithshëm, por nga ana tjetër kemi dendësimin e depërtimit të tij në leksikonin terminologjik. Ky fakt e ka shndërruar terminologjinë në portën kryesore të hyrjes së huazimeve.

Në krahasim me huazimet e leksikut të përgjithshëm, huazimet e terminologjive, si emërtime të gjuhës së shkencës dhe të teknikës, të grupuara në shumë fusha dijeje, vijnë në sasi të mëdha në gjuhë, sidomos sot, nën ndikimin e shfaqjes së pandërprerë të koncepteve, të lidhura me zhvillimin e shkencës dhe të teknologjive moderne, me përdorimin e objekteve të sofistikuar të industrive të reja (të kompjuterit, të celularit etj).

Me fillimin e përdorimit të kompjuterit në Shqipëri vërejmë, siç ka ndodhur edhe në vende të tjera, ndarjen ndërmjet kohës së shkrimit të materialit dhe shtypjes së tij. Me përdorimin e makinës së shkrimit ‘shkrimi’ dhe ‘shtypja’ përkojnë dhe termi që përdoret është *shtyp*. Me kompjuterin shkruajmë dhe pastaj, shtypim. Është ky term në veçanti, në lidhje me shtypjen nëpërmjet kompjuterit, që mungonte në shqip. Hyrja e teknologjisë së re ka futur një term të ri anglo-sakson, *printer*, në fjalorin e shqipes si, *Sot e printova...* Ndërsa, studentët në fjalë janë shprehur në këtë mënyrë *Sapo e stampova. Me doli shumë e bukur*, ku folja *stampo*-va nga italishtja *stampare* na del me mbaresën e së kryerës së thjeshtë të dëftores, veta e parë njëjës.

Shqyrtojmë një tjetër shembull, përsëri në lidhje me teknologjinë, si leximi i një adrese të postës elektronike në gjuhën shqipe dhe italiane: *arben@gmail.com*. Nga folësit L1 lexohet *arben ‘et’ dzimeil. kom*, ndërsa nga ata L2 *arben ‘kiotfolja’ dzimeil. kom*. Siç vërehet, një ndryshim në lexim është shqiptimi i simbolit identifikues të postës elektronike @. Pothuajse të gjithë studentët, madje edhe kur e shqiptojnë në shqip postën elektronike, nuk e përdorin më

at nga anglishtja, por *chiocciola* (sipas shqiptimit në shqip *kioçola*). Këtu ndërrimi i kodit, për më tepër, përdoret se në njoftimin me gojë apo me telefon fjala *kioçola* është më e qartë se *et*, duke mënjanuar, kështu, mundësinë e të gabuarit në dhënien e adresës. Ky këmbim, duket se, po shkon drejt një huazimi për lehtësi komunikimi.

Një rast tjetër është leximi i siglës *sms*, mesazhet elektronike nëpërmjet celularit. Shkurtesa në të dyja rastet, si tek L1 edhe tek L2, është një huazim anglo-sakson (SMS - Short Message Service). Dallimi është në mënyrën se si shqiptohet: në shqip 's'm's' sipas alfabetit të gjuhës shqipe, ndërsa në italisht 'esse' 'emme' 'esse' sipas atij të gjuhës italiane. Edhe në këtë shembull kemi një tjetër ndryshim kodit. Duke dëgjuar me vëmendje studentët, shqiptimi i siglës është ai sipas alfabetit italian, dmth e gjuhë së shumicës.

Siç e pamë më sipër, por edhe nga shembuj të tjerë që kemi vënë re, e folura e grupit vëzhgues është më "e pastër" nga anglicizmat. Në vend të huazimeve angleze që përdoren sot në Shqipëri, studentët shqiptarë në Itali përdorin fjalë italiane, si p.sh. *network-un* kundrejt *la rete* për rrjetin; bëje *shut down/chiudi* për mbylle; hidhe në *recycle bin/cestino* për kosh (me kuptimin *hiqe atë gjë*) etj.

Këto shembuj, edhe pse të pakët, janë të mjaftueshëm për të treguar se ekziston një dallim thelbësor që ka të bëjë me pabarazitë në strukturën semantike të leksemeve midis gjuhëve të kontaktit, shqipes e italishtes.

Nga shqyrtimi i rasteve të mësipërme del se, huazimet janë të përshtatura fonologjikisht ndaj strukturës së shqipes. Rrënjët e huazimeve të tilla (qofshin ato emërore apo foljore) konkretisht, janë të marra nga italishtja, të kompletuara me mbaresa flektive të shqipes dhe të përshtatura ndaj sistemit të saj fonologjik. Huazime të tilla dëshmojnë se këtu kemi të bëjmë me një depërtim të vazhdueshëm të italishtes në të folurit e emigrantëve shqiptarë në përgjithësi dhe, natyrisht, edhe tek studentet tanë të marrë si objekt vëzhgues. Si pasojë, gjuha shqipe e humb pastërtinë e saj, por në të njëjtën kohë dëshmon një funksionalitet dhe jetësi të saj. Themi dëshmojnë jetësinë e gjuhës shqipe në kontakt me gjuhët e tjera, sepse aty shfaqet aftësia e përshtatjes ndaj ndryshimeve jashtëgjuhësore, përderisa shumica e huazimeve nuk kanë fjalë përgjegjëse në shqipen dhe kjo sjell, dëshmon, se shqipja është përdorur në shumë rrjete të ndërveprimit. Për këtë na flet fakti që huazime të tilla janë morfologjizuar (Shkurta, 2009: 340-41).

4. Përfundime

Sigurisht, gjendja e dygjuhësisë ka çuar në ndikime gjuhësore të mëdha, por ato nuk mund të shqyrtohen as kalimthi dhe as në një artikull me karakter të përgjithshëm si ky. Këtu jemi mjaftuar vetëm në dhënien e ndonjë mendimi vëzhgues.

Situata e shqipfolësve në Itali, konkretisht në mjediset universitare, konfirmon hipotezën se dygjuhësit kanë tendencën të ndërtojnë një strukturë uniforme semantike (dhe funksionale) për të dyja gjuhët e kontaktit. Zhvillimet përkatëse gjithmonë çojnë në një nëndiferencim paralel të leksemave ekzistuese ose kategorive gramatikore. Përgjithësisht thithja e kuptimeve të tjera për një leksemë të caktuar ose huazimi e një lekseme të tërë nuk paraqet ndonjë vështirësi. Por është më e komplikuar për dygjuhësit të shkëpusin konceptet e kombinuara në një formë të përbashkët.

Në disa raste ekziston një tendencë për të formuar struktura kalimtare ndërmjet L1 dhe L2, të cilat në disa kuptime janë më komplekse se sa ajo fillestare e çdo gjuhe të vetme të kontaktit. Kështu, struktura komplekse lejon që dygjuhësit të trajtojnë gjuhën e kontaktit si një nënsistem të gjuhës së tyre. Në të shumtën e rasteve e folura e këtij grupi, si produkt i një situatë të kontaktit të ngushtë me folësit dygjuhës, është një demonstrim i integritetit të dy gjuhëve në një sistem për të cilin përgjithësisht dygjuhësit përpiqen.

Emigrantët shqiptarë të fundshekullit XX dhe të dekadave të para të mijëvjeçarit të ri, përbëjnë një bazë të konsiderueshme dhe një aspekt interesant të njohjes së simbiozës së qytetërimeve të pranëvëna dhe gjuhëve në kontakt.

Bibliografia

- Ariffin, K., Rafik-Galea, S. (2009), Code-Switching as a Communication Device in Conversation, *Language & Society*, 5, 9.
- Baker, A., Hengeveld, K. (2012), *Linguistics*, Edited by John Wiley & Sons, 404-407.
- Bista, K. (2010), Factors of Code Switching among Bilingual English Students in the University Classroom: A Survey, *Journal of English for Specific Purpose World* 9 (29), 1-19.
- Breu, W. (2003), Bilingualism and linguistic interference in the Slavic-Romance contact area of Molise, *Words in Time/Diachronic Semantics from Different Points of View*, Mouton de Gruyter, Berlin-New York, 351-373.
- Chini, M. (2004), *Plurilinguismo e immigrazione in Italia. Un'indagine sociolinguistica a Pavia e Torino*, Milano, Editore: Franco Angeli.
- Desmet, T., Duyck, W. (2007), Bilingual Language Processing, *Language and Linguistics Compass*, 1(3), 168-194.
- Filippi, R., Leech, R., Thomas, M. S., Green, D. W., & Dick, F. (2012), A bilingual advantage in controlling language interference during sentence comprehension, *Bilingualism: Language and Cognition*, 15(04), 858-872.
- Fishman, J. (1965), Who speaks, what language, to whom and when, *La Linguistique*, 2.
- Hock, H. H., Brian D. J. (1996), Language History, Language Change, and Language Relationship, *Introduction to Historical and Comparative Linguistics* (2nd Edition), Berlin: Mouton de Gruyter.
- Isufaj, B. (2015), *Gjuha dhe identiteti i shqiptarëve në integrimin evropian* (punim doktore), Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Departamenti i Gjuhës Italiane.
- Jashar-Nasteva, O. (1998), *Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike*, (Përkthyer nga maqedonishtja nga Islam Saliu), Logos-A, Shkup.
- Jorgaqi, K. (1998), Mbi integrimin leksiko-semantik të italianizmave në shqipen standarde, *Studime Filologjike* 1-2.
- Jorgaqi, K. (1997), Rreth përshtatjes morfologjike të huazimeve italiane në shqipen standarde, *Studime Filologjike* 1-4.
- Jorgaqi, K. (1992), Sprovë për identifikimin e huazimeve leksikore italiane në shqipen e sotme letrare, *Studime Filologjike* 1-4.
- Lipski, J. (2005), Code-switching or Borrowing? No sé so no puedo decir, you know, *Selected Proceedings of the Second Workshop on Spanish Sociolinguistics*, 1-15.
- Lipski, J. M. (1976), Structural Linguistics and Bilingual Interference: Problems and Proposals, *Linguistics and bilingual education*, Jamaica, NY: Bilingual Press.
- Lloshi, Xh. (2001), Shqipja standarde në rrethanat e dygjuhësisë, *Studime Filologjike*, nr.3-4, 50.
- Muysken, P. (2000), *Bilingual speech: A typology of code-mixing*, Cambridge University Press.
- Poplack, S., Sankoff, D., Miller, C. (1988), The social correlates and linguistic processes of lexical borrowing and assimilation, *Linguistics* 26, 47-104.
- Rrokaj, Sh. (2014), *Çështje të gjuhës shqipe*, 3, Tiranë, f.37.

- Soh, KC (2012), Bilingual testing at the phrase and text levels and its implications for bilingual programmes, *Linguistics and Language Teaching* 3, Issue 2, 249-264.
- Shkurtaj, Gj. (2009), *Sociolinguistikë e shqipes*, Tiranë, Shtëpia Botuese MORAVA, 278-301; 322-343.
- Vicentini, A. (2003), Notes and Observations from Early Modern English Grammars, *The Economy Principle in Language*, Mots Palabras Words - 3, 37-57.
- Weinreich, U. (1964), *Languages in Contact: Findings and Problems*, The Hague: Mouton [1953].